

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË “STUBRN” SH.P.K.**

Sot më datë 25.10.2020, ortaket themelues te mëposhtëm:

- **Z. SPIRO JOVANI, i datëlindjes, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotëpër të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. 033408269 dhe Nr. Personal J90319046O, i datëlindjes 19.03.1999.**

I cili përpiloj këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare “STUBRN” SHPK sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

**Neni 1
Forma Ligjore**

Të themelojë Shoqërinë tregtare “STUBRN” SHPK themelohet në formën e një shoqërie me perjegjesi te kufizuar. Në të gjithë aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjithë aktet e brendëshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “STUBRN” SHPK sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

**Neni 2
Qëllimi i krijimit të shoqërisë**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe me qëllim fitmprurës.

**Neni 3
Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria do të dalë në qarkullim juridiko-civil me emrin e subjektit “STUBRN” SHPK. Dhe emrint tregtar “STUBRN” SHPK. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**Neni 4
Objekti i shoqërisë**

Shoqëria aksionare do të zhvillojë aktivitet ne fushat e meposhtme:

Objekti kryesor i shoqerise eshte:

- Shitje me pakicë ndërmjet aplikacioneve të kryera jo nga dyqanet.
- Shërbime ndërmjetësimi , veprimi si ndërmjetës mes konsumatorëve dhe bizneseve dhe ndërmjet bizneseve si dyqane të kategorive të ndryshme (dyqane të ndryshme rrobaresh, lulesh, këpucësh, markete, farmaci,bare-restorante)etj.
- Shërbime postare të ndryshme me transport me moto-mjet, bicikleta, automjete brenda Shqipërisë dhe jashtë saj nëpërmjet platformës sociale që do përdori shoqëria.
- Import – eksport të mallrave të ndryshme përfshirë veshmbathje, pajisje elektronike



të ndryshme, parfumeri,etj.

- Shërbime konsulence dhe marketing të platformës së shoqërisë.
- Prodhimë dhe tregtim të produkteve të ndryshme (aksesorë, rroba etj) të personalizuara nga shoqëria.
- Të ushtrojë të gjitha llojet e transporteve për të gjitha llojet e produkteve me delivery
- Kryerja e sherbimeve per te trete te dergesave te artikujeve te ndryshme , si kolive , pakove nga shitesi tek klienti ,veprimtari transporti tokësor te cdo natyre dhe me cfaredo mjeti transporti.
- Te perfasesoje biznese shqiptare ose te huaja te lidhuara me objektin e Shoqerise
- Të marrë ose japë hua, të pranojë garanci personale ose garanci të tjera, të marrë përsipër detyrime, te leshojë kambiale, urdhërpagesa, çeqe ose obligacione ose garanci ose tituj dhe të emetoje garanci te tjera financiare.
- Shoqeria mund te kryej gjithashtu gdo veprim tregtar, biznesi, industrial apo finanziar me qellim arritjen e objektivave te aktivitetit tregtar te shoqerise si dhe gdo veprim dhe transaksion ne lidhje me pasuri te luajtshme e te paluajtshme te cilat jane te nevojshme ose te pershtatshme per arritjen e objektivave te shoqerise.

Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet dhe aktivitetet e duhura me qëllim përbushjen e qëllimit të biznesit sipas legjislacioneve përkatëse në fuqi.

Neni 5

Zyra qëndrore e shoqërisë dhe afati

Zyra qëndrore e shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës në Rrugën e Kavajës, Nr. Pasurie 6/324+3-N7 .

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj shoqërie.

Kapitali në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 100 000 Lekë (njëqind mijë lekesh), Vlera totale e kapitalit të rregjistruar :100,000 (njëqind mijë lekë).

Vlera e paguar 100,000 (njëqind mijë lekë).

Numri total i kuotave 1(një).

Neni 7

Ortaku themelues të shoqërisë “STUBRN” SHPK zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:



1. Spiro Jovani, zoteron 100% te vleres totale te te gjitha kuotave te kapitalit themeltar, qe eshte e barabarte me 1(një) kuotë per nje kontribut ne para prej 100 000 lekë (njëqind mijë Leke).
2. Numri i kuotave është 1(një)
3. Numri i pjesëve 1 (një)
4. Pjesëmarrja në shoqëri 100%
5. Lloji I kontributit në para
6. Vlers e kontributit 100,000 (njëqind mijë lekë)

Duke qënë se Kapitali Themeltar do të depozitohet në llogarinë e shoqërisë e cila do hapet pas rregjistrimit në QKB, atëherë ortaku vendos që kjo shumë do të paguhet prej tij jo më vonë se tre muaj nga data e rregjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare.

Rregullat e pagesës së kësaj shume janë parashikuar në Statut.

Neni 8

Organet e Shoqërisë

Sipas Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve-Organi më i lartë vendimarrës;
- 2- Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

Neni 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5 vjecar me të drejtë rizgjedhje per nje afat qe do te percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme.

- Administrator i shoqerise eshte **Z. SPIRO JOVANI, i datëlindjes , shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotëpër të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. 033408269 dhe Nr. Personal J90319046O**

Shoqëria përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marredhënie me të tretët nga Z. Spiro Jovani, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë, kufizimet respektive ne tagrat e tij dhe legjislacionin në fuqi.

Specifisht ne lidhje me organizimin, mbikqyrjen dhe implementimin e te gjitha programeve dhe projekteve qe shoqeria, ne perputhje me qellimet e saj, do te ndermanorre persiper te perm bush, do te menaxhohet dhe administrohet **vetem** nga **Spiro Jovani**.

Nese administratori/ët do te kryej veprimeve juridike qe tejkalojne tagrat ose kompetencat e tij ose vepron ne shkelje te klauzolave te ketij statuti, ai do mbaj



pergjegjesi personale per te detyrimet qe ai do te marre persiper kundrejt paleve te treta, duke mos patur asnje lloj pasoje financiare per shoqerine ose ortaket e saj.

Neni 10

Viti finanziar, pasqyrat vjetore financiare

Viti finanziar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë finanziar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

Në fund të cdo viti finanziar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:

- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
- (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
- (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.

Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

Neni 11

Fitimi i Shoqërise

Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri si më poshtë:

(a) 100 % (njeqind përqind) e fitimit do t'i shpërndahet z. Spiro Jovani si pronar i pjesës të barabartë me 100.000 LEKE që përfaqësojnë 100 % (njeqind perqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;

Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërise në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tativore përparrë fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

Neni 12

Prishja dhe likuidimi

Shoqëria do të prishet në rastet e mëposhtme:

- (a) Me vendim te mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
- (b) Ne rast bashkimi me një shoqëri tjeter;
- (c) Ne baze te nje vendimi te gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
- (d) Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj;
- (e) Perfundimi i akt marreveshjes private lidhur midis ortakeve;

Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.



Neni 13
Konfidencialiteti

Ortaket detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimarisë së tyre.

Neni 14
Te per gjithshme

Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiken t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridikSION përkatës.

Ligji i aplikueshem eshte legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Akti i themelimit është përpiluar në pesë kopje originale në gjuhën Shqipe, Angleze dhe Greke me vlerë të njëjtë.

Ne Tirane me 25.10.2020

ORTAKET THEMELUES
ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
Spiro Jovani

Spiro Jovani 